

**DEKLARATA INDIVIDUALE
VJETORE E TË ARDHURAVE**Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore (viti)

(1) Numri Serial:

Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit
KORRIGJUESE**SEKSIONI A : TË DHËNA IDENTIFIKUESE**[3] REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË [4] JOREZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË **TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR INDIVIDIN**(5) Emri _____, Atësia _____; Mbiemri _____, Seksi: M F

(6) Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit _____

(7) Adresa kryesore: _____

(8) Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

(9) Statusi i Deklaruesit I/E martuar I/E martuar me Beqar/e I/E ve I/E divorcuar Kryefamiljar/e
 fëmijë **TË DHËNA PLOTËSUESE PËR INDIVIDIN**

(10) Telefoni _____, Cel. _____, E-mail _____

(11) Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore: a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Te tjere

(12) Emër/Mbiemër i pronarit _____, Adresa _____

ADRESA E BANIMIT NËSE ËSHTË E NDRYSHME NGA ADRESA E TË DHËNAVE IDENTIFIKUESE

(13) Adresa _____

(14) Nr. Tel: _____, Cel _____, E-mail _____

(15) Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton : a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Të tjere

(16) Emri /Mbiemri i pronarit _____ Adresa _____

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2016

Udhëzim Nr. 5, datë 30.01.2006

PERSONA NË KUJDESTARINË E DEKLARUESIT

(17) Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej Numri i personave brenda familjes në kujdestari Të tjerë persona në kujdestari

Personi Deklarues
(Emri/Mbiamri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

(1) Numri Serial: _____

NVD: _____

(2) Periudha tatimore (viti) _____

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

[3]	Të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit	[3]
[4]	Tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet e punësimit.....	[4]
[5]	Të ardhurat bruto nga dividendi	[5]
[6]	Të ardhurat bruto nga qiraja.....	[6]
[7]	Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit.....	[7]
[8]	Të ardhurat bruto nga interesat bankare.....	[8]
[9]	Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme.....	[9]
[10]	Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit.....	[10]
[11]	Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, liçensa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbehen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike.....	[11]
[12]	Fitime kapitali nga dhurimi.....	[12]
[13]	Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.....	[13]
[14]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart	[14]
[15]	SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO (Kutia 3 + kutia 5 deri 14).....	[15]

SHPENZIME TË ZBRITSHME

[16]	Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim	[16]
[17]	Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe për personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.....	[17]
[18]	SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME (kutia 16 deri 17)	[18]

TATIMI I LLOGARITUR PER T'U PAGUAR

[19]	Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga punësimi (kutia 15 – kutia 3), [minus shpenzimet e zbritshme në rast se kutia 15 ≤ 1.050.000](kutia 15-kutia 3 – kutia 18)]... ..	[19]
[20]	Tatimi llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi (kutia 19 x 15%)....	[20]
[21]	SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR (kutia 4 + kutia 20)	[21]

TATIMET E PAGUARA GJATE PERIUDHES TATIMORE

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2016

Udhëzim Nr. 5, datë 30.01.2006

[22]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit.....	[22]
[23]	Tatimi mbi dividendin.....	[23]
[24]	Tatimi mbi qiranë.....	[24]
[25]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme.....	[25]
[26]	Tatimi mbi interest bankare.....	[26]
[27]	Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme...	[27]
[28]	Tatimi mbi fitimet në nga lotaritë apo lojrat e tjera të fatit.....	[28]
[29]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat e rubrikës [11].....	[29]
[30]	Tatimi nga të ardhurat nga fitimet kapitale nga dhurimi.....	[30]
[31]	Tatimi mbi të ardhura të tjera.....	[31]
[32]	Tatimi mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.....	[32]
[33]	Kreditimi i tatimit të huaj.....	[33]
[34]	SHUMA E TATIMIT TE PAGUAR (Kutia 22 deri kutia 32).....	[34]
[35]	TATIMI I DETYRUAR PER T’U PAGUAR (kutia 21-kutia 34).....	[35]
[36]	TATIMI I PAGUAR TEPER (kutia 34-kutia 21).....	[36]

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

- 1. Numri serial** përdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore (organi tatimor) dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.
- 2. Periudha Tatimore** është periudha që përfshin deklarin nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit raportues.

SEKSIONI A : TE DHENA IDENTIFIKUESE

Të dhëna identifikuese për individin.

- 3. Rezident në Republikën e Shqipërisë.** Plotësohet duke vendosur shenjën “X” në kutinë nëse individ është resident në Republikën e Shqipërisë.
- 4. Jo-Rezident në Republikën e Shqipërisë.** Plotësohet duke vendosur shenjën “X” në kutinë nëse individ nuk është resident në Republikën e Shqipërisë.
- 5. Emri, Atësia, Mbiemri, Seksi,** plotësohet me të dhënat e individit i cili deklaron me anë të kësaj deklarate, me gërma kapitale.
- 6. Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit** plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftim ID-së (në kartën e identitetit).
- 7. Adresa kryesore** plotësohet për adresën që deklaruesi ka sipas të dhënave në regjistrin e gjëndjes civile.
- 8. Qyteti/Komuna/Rrethi** plotësohet sipas regjistrin të gjëndjes civile.
- 9. Statusi i Deklaruesit** plotësohet duke vendosur shenjën “X” brënda kutive.

Të dhëna plotësuese për individin

- 10. Telefon, Celular, E-mail,** plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e_mailit, që disponon deklaruesi.
- 11. Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore** plotësohet duke vendosur shenjën “X” nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokumenta ipoteke, marrë me qira apo është dhënë falas në përdorim dhe të tjerë.
- 12. Emër/Mbiemër i pronarit, Adresa** plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ja ka lënë në përdorim falas, e të tjerë.

Adresa e banimit nëse është e ndryshme nga adresa e të dhënave identifikuese.

- 13. Adresa** e banimit të deklaruesit nëse ka ndryshuar nga adresa e deklaruar në të dhënat identifikuese.

14. Numri i telefonit, Celulari, E-mail, plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit nëse ka ndryshuar, nga të dhënat identifikuese.

15. Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton, plotësohet duke vendosur shenjën “X” nëse banesa është në pronësi të deklaruesit, marrë me qira apo është dhënë falas.

16. Emër/Mbiemër i pronarit, Adresa plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ia ka lënë në përdorim falas.

17. Persona nën kujdestarinë e deklaruesit, plotësohet nga kryefamiljari apo bashkëshortja kur kjo është kryefamiljare duke vënë në kuti, numrin e personave brenda familjes në kujdestari dhe numrin e të tjerë personave në kutinë tjetër.

SEKSIONI B : TË DHËNA PER LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

3. Të ardhurat bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, plotësohet për totalin e pagave dhe shpërblimeve që deklaruesi përfiton nga të gjitha marrëdhëniet e punësimit gjatë periudhës tatimore.

4. Tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, do të jetë fushë e lirë dhe do të plotësohet nga vetë deklaruesi. Shuma e tatimit të vendosur në këtë kuti, në asnjë rast nuk mund të jetë më e vogël se tatimi i mbajtur në burim dhe i paguar nga punëdhënësi për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit. Kjo fushë do të plotësohet nga individ i deklarues, i cili do të llogarisë tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet për të gjitha të ardhurat që përfitohen gjatë muajit, edhe kur ai i përfiton ato nga punëdhënësi të ndryshëm. Në rastin kur shuma e të ardhurave të përfituara gjatë muajit nga dy apo më shumë punëdhënësi e kalojnë vlerën që tatóhet me zero përqind (30,000 lekë), tatimi do të llogaritet mbi totalin e të ardhurave mujore (totali i të ardhurave nga të gjithë punëdhënësit). Tatimi i llogaritur në këtë mënyrë për çdo muaj të vitit, mbledhet për 12 muajt e vitit dhe hidhet në një shumë të vetme në këtë fushë, e cila përfaqëson tatimin vjetor të llogaritur për pagat dhe shpërblimet. Në rast se shuma e të ardhurave të përfituara gjatë një muaji nga një apo më shumë punëdhënësi është nën kufirin e tatueshëm (30,000 lekë), kjo fushë do të jetë zero.

5. Të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëritë tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit, do të plotësohet për shumën e dividendit që individ i deklarues përfiton nga të gjitha pjesëmarrjet e tij në shoqëritë tregtare, apo veprimtaritë e biznesit.

6. Të ardhurat bruto nga qiratë, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto që individ i realizon nga dhënia me qira e një ose disa objekteve.

7. Fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të individit deklarues, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individ i deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme gjatë periudhës tatimore.-

8. Të ardhurat bruto nga interesat bankare, do të plotësohen për totalin e të ardhurave nga interesat bankare që individ i deklarues ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.

9. Fitimi kapital neto i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtëshme, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga investimet në tituj, shitje aksionesh, e pasuri të paluajtëshme, duke përfshirë të ardhurat që janë pasqyruar në kutinë 7. Me termin “fitim kapital i realizuar” kuptohet diferenca ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë.

10. Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit, do të plotësohet për totalin e shumave bruto të fituara nga lotaritë apo lojra të tjera të fatit.

11. Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale liçensa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto nga të gjitha, sa përshkruar më sipër.

12. Fitimet kapitale nga dhurimi, do të plotësohet për shumën e fitimeve kapitale të realizuara nga dhurimi.

13. Të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të realizuar nga individit deklarues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

14. Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të tjera, të cilat nuk janë të përfshira në të ardhurat e sipërsënuara.

15. SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO(3-14) plotësohet për shumën totale të të ardhurave të deklaruara nga individit nga kutia 3 deri në kutinë 14 pa përfshirë shumën në kutinë 4 (kutia 3 + kutia 5 deri kutia 14).

SHPENZIME TË ZBRITËSHME

16. Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, do të plotësohet për shumën e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim nga banka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

17. Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, do të plotësohet mbështetur në faturat e lëshuara nga institucionet shëndetësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për justifikimin e shpenzimeve për mjekim, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

18. SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITËSHME, plotësohet për totalin e shpenzimeve nga kutia 17-18.

TATIMI I LLOGARITUR PËR T’U PAGUAR

19. Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga punësimi (kutia 15 – kutia 3), [minus shpenzimet e zbritshme në rast se kutia 15 ≤ 1.050.000](kutia 15-kutia 3 – kutia 18)], plotësohet për diferencën ndërmjet shumës totale të të ardhurave bruto të **tatueshme (kutia 15) duke i zbritur të ardhurat bruto të tatueshme nga pagat në lidhje me marrëdhëniet e punësimit. Në rast se të ardhurat bruto në kutinë 15 janë më të vogla ose të barabarta me 1.050.000 lëke, të ardhurave të tatueshme i zbriten shumat e shpenzimeve të zbritshme (kutia 18). Përfitojnë shpenzime të zbritshme të gjithë individët, të cilët kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë.**

20. Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme përveç të ardhurave nga punësimi, plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton sipas formulës: (shuma kutia 15 minus shuma kutia 3)*15%. -

21. SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR, plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton nga mbledhja e tatimit të llogaritur nga individit deklarues mbi pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punësimit (kutia 4) me shumën e tatimit të llogaritur për të gjitha të ardhurat e tjera të tatueshme (kutia 21), pra shuma në kutinë 4 + shuma në kutinë 21.

TATIMET E PAGUARA GJATE PERIUDHES TATIMORE

Kutia 22 Tatimi mbi të ardhurat bruto nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punësimit, plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga punëdhënësi/punëdhënësat për pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Kutitë 23 deri kutia 31 plotësohen me shumën e tatimit të paguar për të ardhurat e përfituara nga të gjitha burimet nga individit deklarues, përveç të ardhurave nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Kutia 32 Tatimi mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësohet me shumën e tatimit të paguar jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kutia 33 Kreditimi i tatimit të huaj, do të lejohet në rastet kur të ardhurat janë realizuar dhe tatimi për keto të ardhura është paguar në një shtet tjetër sipas përcaktimeve të nenit 37 të ligjit të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998.

Do të lejohet kreditimi i tatimit të huaj të paguar jashtë deri në masën sa këto të ardhura individuale të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë taten sipas dispozitave të nenit 9, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998.

Nëse të ardhurat individuale të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë tatuar me shkallë tatimore më të vogël se ajo e përcaktuar në legjislacionin vendas, do të lejohet kreditimi i tatimit të huaj deri në masën e tatimit të huaj të paguar.

34. SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR GJATË PERIUDHËS TATIMORE, plotësohet për shumën e tatimit të paguar nga kutia 23 deri në kutinë 34 të deklaratës.

35. TATIMI I DETYRUESHEM PER T'U PAGUAR, (kutia 22 minus kutinë 35) plotësohet për diferencën midis shumës së tatimit të llogaritur sipas deklaratës (kutia 22) minus shumën e tatimit të paguar (kutia 35) minus tatimin e paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe i parimbursuar (kutia 29).

36. TATIMI I PAGUAR TEPËR (për rimbursim), plotësohet për diferencën nëse tatimi i paguar gjatë periudhës tatimore (kutia 35) është më i madh se tatimi i llogaritur sipas deklaratës (kutia 22).

Në fund të faqes së parë, të dytë dhe të tretë të vendoset emri, mbiemri, firma e deklaruesit dhe data e deklaramit.